V E N D I M
Nr.262, datë 24.4.2003

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2003, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR HAPJEN E KUTIVE TË VOTIMIT TË PËRDORURA NË ZGJEDHJET PËR DEPUTET NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË DATËS 24 QERSHOR 2001

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003" dhe nenit 137 pika 2 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2003, t'i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, për financimin e shpenzimeve për hapjen e kutive të votimit të përdorura në zgjedhjet për deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 24 qershor 2001.

1. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano